



unicef 
for every child

UDHËZIM SI TË GARANTOJMË SIGURINË E FËMIJËVE NË PLATFORMAT E MËSIMIT ONLINE NË SHQIPËRI

Për autoritetet arsimore që dëshirojnë që të krijojnë platforma të mësimit online përmes palëve të treta të ofrimit të shërbimeve, në përgjigje të emergjencës së krijuar

Hyrje

Sigurimi i vazhdimësisë së mësimit, pavarësisht problematikave dhe sfidave që emergjenca e COVID-19 ka sjellë në rutinën e sistemit arsimor, është thelbësor për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve. Përdorimi i platformave të mësimit online, që përfshin një paketë shërbimesh online që arsimtarët, mësuesit dhe prindërit mund të përdorin për të mbështetur klasat virtuale, ka hapur dyert për mënyra të reja e novatore në mësimdhënie, të nxënësve dhe vlerësimit të ecurisë së nxënësve. Platformat e mësimit online janë mjete të fuqishme që do të ndihmojnë mësuesit të japin mësim dhe nxënësit ta ndjekin atë, por ato mbartin edhe rrezikun që të dhënat personale të përdoren në mënyra të papërshtatshme. Ato mund të paraqesin kërcënim të privatësisë që vjen nga mbledhja,

përdorimi, ripërdorimi, zbulimi dhe ruajtja e të dhënave personale të fëmijëve.

Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë që t'iu mbrohet privatësia dhe të mund të ushtrojnë të drejtat për mbrojtjen e të dhënave me mbështetjen e prindërve ose kujdestarëve sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Prindërit duhet të kenë mundësinë të ndihmojnë fëmijët e tyre dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në ushtrimin e këtyre të drejtave.

Studimi kombëtar i UNICEF Shqipëri në vitin 2019 “Një klikim larg” nxori në pah një hendek të madh në njohuritë dhe aftësitë digjitale midis fëmijëve dhe prindërve. Prindërit dhe kujdestarët kanë njohuri, aftësi dhe mjete të kufizuara për të zbutur rrezikun ndaj të cilit ekspozohen fëmijët ndërkohë që janë online. Fëmijët shprehen se pjesa më e madhe e prindërve të anketuar nuk ndërmarrin një qasje aktive prindërimi lidhur me

përdorimin e internetit nga fëmijët e tyre dhe përdorimi i mekanizmave të kontrollit prindëror prej tyre duket se është në nivel të ulët. Duke marrë në konsideratë sa më sipër, autoritetet arsimore në bashkëpunim të ngushtë me organet qeveritare përkatëse, rregullatorët kombëtarë dhe industrinë e TIK do të angazhohen që siguria dhe privatësia e fëmijëve të konsiderohet një prioritet kyç, çdoherë që interneti përdoret për qëllime mësimore.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të mbështesë autoritetet arsimore të përfshijnë elementë të mbrojtjes së fëmijëve online para, gjatë dhe pas ngritjes së platformave të mësimit online. Përveç ofrimit të mundësive për mësim në distancë nëpërmjet internetit, këto platforma duhet të konsiderohen si një mënyrë efikase për të pajisur fëmijët, prindërit dhe mësuesit me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të qenë të sigurtë online dhe për të përdorur internetin në dobi të tyre.



Mbrojtja e sigurisë dhe privatësisë së fëmijëve

Autoritetet arsimore duhet të respektojnë plotësisht të drejtat e nxënësit për sigurinë, privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave të tyre personale dhe të garantojnë se të dhënat e mbledhura nga platformat e mësimi online përdoren vetëm për qëllime mësimore në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Autoritetet arsimore duhet të:

1. Sigurojnë që kontratat me ofruesit dhe prodhuesit e platformave të mësimi online t'i kushtojnë vëmendje të veçantë sigurisë dhe privatësisë së fëmijëve në të gjitha teknologjitë mësimore në përputhje me ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

⇒ Sigurojnë që termat dhe kushtet e marrëveshjeve/kontratave institucionale me ofruesit e shërbimit të platformës online ose palëve të treta të jenë të qarta dhe të kenë parashikuar kontrolle (duke përfshirë administrimin dhe hostimin e serverit, mirëmbajtjen e bazave të të dhënave të platformave dhe të dhënave të ruajtura në server, fshirjen e të dhënave personale, etj);

⇒ Sigurojnë që qëllimet për të cilat po mblidhen të dhënat personale të fëmijëve janë të kufizuara

në nevojat mësimore dhe nuk iu bëhen të ditura palëve të treta tregtare;

⇒ Sigurojnë që mjetet e komunikimit në platformën online (p.sh. chat-et si tawt.to) duhet të kenë të përcaktuara politika të mbrojtjes në termat e komunikimit të drejtpërdrejtë me fëmijët dhe monitorimit të të dhënave të ndara nëpërmjet aplikacionit të chat-it.

2. Sigurojnë që ekspertiza e TIK të ofrojë monitorim të vazhdueshëm të platformave online, si dhe të mbrojë dhe të ofrojë asistencë për shkollat;

3. Sigurojnë që të vendoset një pikë kontakti nga institucioni arsimor përkatës ku fëmijët, prindërit dhe mësuesit t'i drejtohen për pyetje dhe shqetësime lidhur me sigurinë dhe privatësinë e tyre;

4. Sigurojnë që Termat dhe Kushtet, Politikat e Privatësisë dhe Kushtet e përdorimit të platformës së krijuar të mësimi online të jenë të qarta për fëmijët, prindërit dhe mësuesit:

⇒ Sigurojnë që informacioni të jetë i thjeshtë për t'u aksesuar dhe i përshtatshëm për moshën përgjatë dhe pas regjistrimit në platformë ose krijimit të profilit personal;

⇒ Ofrojnë, kur të jetë e mundur, materiale audio/video për fëmijët, prindërit dhe mësuesit, duke shpjeguar në gjuhë të kuptueshme termat e politikave të shërbimit dhe

privatësisë të platformës;

⇒ Ndalojnë ruajtjen, ndarjen ose shpërndarjen e çdo përmbajtjeje të papërshtatshme për fëmijë në internet (materiale për të rritur, reklama, materiale me përmbajtje dhune, etj.);

⇒ Sigurojnë që platforma ofron një mjet raportimi me anë të të cilit fëmijët të raportojnë kur shohin ose kanë përvoja me përmbajtje të papërshtatshme në platformë.

5. Sigurojnë mbikëqyrjen dhe kontrollin prindëror mbi aktivitetin e fëmijëve në platformë. Ofrojnë materiale ose tutoriale audio/vizuale në mënyrë që prindërit t'i kuptojnë më mirë kushtet e përdorimit. Sigurojnë që është marrë pëlqimi paraprak nga prindërit në rast se platforma u mundëson fëmijëve të postojnë ose ngarkojnë materiale audio/vizuale ose tekst.

6. Ofrojnë ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetje të vazhdueshme për mësuesit, duke përfshirë aksesin në burime, trajnime dhe seminare nëpërmjet uebit (webinars), për t'iu mundësuar të ofrojnë udhëzime dhe mbështetje efikase ndaj nxënësve dhe prindërve mbi privatësinë, mbrojtjen e të dhënave personale dhe problemet e mbrojtjes së fëmijëve online.

7. Përfshijnë materiale edukative audio/vizuale të përditësuara dhe të dobishme mbi mbrojtjen e fëmijëve online në platformën e mësimi online në mënyrë që fëmijët, prindërit dhe mësuesit të përparojnë me aftësitë e tyre për mbrojtjen online dhe njohuritë digjitale, duke përfshirë abuzimin seksual të fëmijëve dhe shfrytëzimin online, bulizmin kibernetik, 'netiquette'-n (etikën dhe sjelljen online), keqinformimin, etj.

Sigurojnë që e gjithë përmbajtja mësimore digjitale të përshtatet me standartet e "përmbajtjes së aksesueshme në ueb" për fëmijët me aftësi të kufizuara që përdorin teknologjitë ndihmëse.



Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 ‘Për mbrojtjen e të dhënave personale’

https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/03/Ligj_Nr.9887_datë_10.3.2008_i_ndryshuar.pdf

Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (RPMdH)

<https://gdpr-info.eu/>

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, “E drejta për privatësi në epokën digjitale” A/RES/68/167

<https://undocs.org/pdf?symbol=en/a/res/69/166>

Rezoluta për platformat e mësimin online (Konferenca e Komisionerëve për Mbrojtjen e të Dhënave)

https://edps.europa.eu/sites/edp/files/publication/icdppc-40th_dewg-resolution_adopted_en_0.pdf

Shembuj të Politikave të Privatësisë nga platforma të ngjashme të mësimin online

<https://www.classdojo.com/privacy/>

Shembull i një videoje miqësore me fëmijët që shpjegon politikën e privatësisë

<https://vid.ly/7d4i1b>

Shembuj të zgjidhjeve për mësimin online lidhur me çështje të sigurisë dhe privatësisë

<https://en.unesco.org/covid19/educationresponse/solutions>

Listëkontrolli për kompanitë mbi privatësinë dhe lirinë e shprehjes së fëmijëve online.

[https://www.unicef.org/csr/files/UNICEF_Childrens_Online_Privacy_and_Freedom_of_Expression\(1\).pdf](https://www.unicef.org/csr/files/UNICEF_Childrens_Online_Privacy_and_Freedom_of_Expression(1).pdf)

Udhëzime për Industrinë mbi mbrojtjen e fëmijëve online

<https://digital-protection.org/2019/07/02/guidelines-for-industry-on-child-online-protection/>

Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijët – ALO 116 111

<https://www.alo116.al/>

Këshillim psikosocial

<http://nukjevetem.al/>

Friendly WiFi

<http://friendlywifi.al/>

Kuiz për fëmijë mbi sigurinë e fëmijëve online

<http://friendlywifi.al/sq/ichild-loj%C3%AB-p%C3%ABr-sigurin%C3%AB-e-f%C3%ABmij%C3%ABve-online-0>

Manuali ”Këshilluesit e vegjël për sigurinë online”

<https://www.unicef.org/albania/media/1266/file/Manual%20for%20Peer%20Educators%20.pdf>

Aksesi në shkolla dhe mjedisin mësimor I -aksesi fizik, informacioni dhe komunikimi

https://www.ded4inclusion.com/uploads/4/7/7/8/47789531/10.access_to_environment_i.pdf